

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQERISE "MADALIN" SHPK

NENI 1 - ORTAKET THEMELUES

1.1 Shoqëria MADALIN SHPK themelohet nga Ortaket:

Znj.ERMALINDA GJANI, shtetas shqiptar, lindur me 15.07.1985, banues ne Tirane, mbajtes i Nr. Personal I55715073I madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar;

dhe

Z. NIKO GJANI, shtetas shqiptar, lindur me 29.03.1982, banues ne Tirane, mbajtes i Nr. Personal I20329001L, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar;

EMERTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

NENI 2 — EMERTIMI

2.1 Emertimi i shoqërise është MADALIN SHPK (me poshte e quajtur "Shoqëria").

NENI 3 - FORMA LIGJORE

3.1 Shoqëria është e formes me pergjegjesi te kufizuar dhe është themeluar ne perputhje me legjislacionin tregtar ne Shqiperi.

3.2 Shoqëria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 4 - BAZA LIGJORE

4.1 .Shoqëria do te zhvilloje yepimtarine e saj ne perputhje me kete Akt Themelimi dhe Statut, legjislacionin tregtar dhe dispozita te tjera ligjore ne fuqi.

4.2. Per sa nuk është parashikuar ne kete Statut, do te aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008. "Per tregtaret dhe shogerite tregtare", i ndryshuar.

4.3.Cdo mosmarreshje qe mund te lind ne lidhje me zbatimin dhe/ose interpretimin e ketij Statuti, do te zgjidhet nga gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 5 - PERSONALITETI JURIDIK. KOHEZGJATJA

5.1 Shoqeria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne Tirane, Shqiperi.

5.2 Afati i veprimtarise se shoqerise eshte i pakufizuar.

NENI 6 - SELIA

6.1 Selia e shoqerise eshte ne adresen: Njesia Bashkiake nr.6, zona kadastrale 3866, Yzberisht, Rr.Teodor Keko ", Tirane, Shqiperi.

6.2 Shoqeria mund te hapë dege, filiale apo zyra perfaqesie si brenda territorit te Shqiperise ashtu dhe jashte saj.

6.3 Shoqeria mund te marre pjese ne shoqeri te tjera Shqiptare ose te huaja qe ekzistojne ose do te krijohen ne te ardhmen.

NENI 7 - OBJEKTI

8.1 Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jete:

a) Tregti me shumice e pakice e paisjeve mjekesore, materialeve dentare dhe laboratorike dentare.

b) Import - eksport me pakice dhe shumice i mallrave mjekesore dhe materialeve te ndryshme.

c) Ruajtje, shperndarje, shitje me paikice dhe shumice te paisjeve mjekesore për të tretet.

NENI 8- VULA & EMBLEMA

Shoqeria do te kete emblemen dhe vulen e saj. Vula do te perdoret nga administratori e shoqerise.

NENI 9— KAPITALI THEMELTAR

9.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100.000 (leke).

9.2 Kapitali themeltar perbehet nga 2 (dy) kuota.

9.3 Pjeset e kapitalit themeltar zoterohen nga ortaket ne masen si me poshte:

Znj. Ermalinda Gjani zoteron 1 (nje) kuote me vlere nominale 51,000 (pesedhjete e nje mije) Leke qe perben 51%te kapitalit themeltar te shoqerise.

Z. Niko Gjani zoteron 1 (nje) kuote me vlere norninale 49,000 (dyzet e nente mije) Leke qe perben 49% te kapitalit themeltar te shoqerise.

9.4 Pergjegjesia e Ortakeve shtrihet deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin e Shoqerise.

NENI 10 - TRANSFERIMI I KUOTAVE. KUFIZIMET

10.1 Kuota e kapitalit eshte e transferueshme dhe mund te transferohet ne cdo moment sipas kushtev edhe afateve te parashikuara nga ligji shqiptar.

10.2 Vendorsja e cfaredolloj barre mbi pjeset e kapitalit ne favor te paleve te treta do te lejohet vetem me pelqimin e Asamblese se Ortakeve.

ORGANET E SHOQERISE

NENI 11 - VENDIMET E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

11.1 Asambleja e Ortakeve ne perputhje me legjislacionin shqiptar, mund te vendose, por pa u kufizuar ne to, vendimet me poshte:

-Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise dhe mbikeqyrjen e zbatimit te tyre nga administrator ose administratoret, perfshi raportet financiare; zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;

-Miratimin e shkrirjes/bashkimit me shoqieri te tjera ndryshimin e statutit te shoqerise;

-Ndryshimin e selise dhe te emertimit te shoqerise; emerimin e eksperteve kontabel te autorizuar, ne qofte se eshte e nevojshme; Rritjen ose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise;

-Shitjen ose transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar paleve te treat ; Ristrukturimin dhe prishjen shoqerise; Emerimin ose shkarkimin e administratorit ose adnnistratoreve te shoqerise;

-Miratimin e pasqyrave financiare te shoqerise dhe raportit te administatorit(eve);

-Vendimin per shperndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve transformimin e shoqerise ne forma te tjera; dhe cdo lende tjeter te parashikuar nga statuti ose nga ligji.

NENI 12 - ADMINISTRIMI

12.1 Administratori emerohet me vendim te Asamblese se Ortakeve. Ne rast se Shoqeria do te administrohet nga me shume se nje administrator, atehere administratoret mund ti ushtrojne kompetencat bashkerisht ose vecrnas sikurse do te percaktohet ne vendimin perkates te Asamblese se Ortakeve.

12.2 Administratori i pare i shoqerise eshte:

Znj. Ermalinda Gjani shtetas shqiptar, lindur me 15.07.1985, banues ne Tirane, mbajtes i Ni. Personal: I55715073I me afat 5 vjecar.

12.3- Administratorit(ve) u jepen te gjitha kompetencat e percaktuara nga legjislacioni i Republikes se Shqiperise, duke perfshire, por pa u kufizuar ne to, Administratori(et) jane pergjegjes per veprimtaritee meposhtme:

Drejtimin e veprimtarise se perditshme te shoqerise; Perfaqesimin e shoqerise ne marredheniet me te tretet personalisht ose me perfaqesim: Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;Pergatitjen e dokumenteve no emer te shoqerise sipas kompetencave qe zoteron; Te lidhe kontrata per dhe ne emer te shoqerise me pale te treta, te punesoje dhe pushoje punernarres apo staf tjetet qe konsiderohet i nevojshem per mbarevajtjen e aktivitetit teshoqerise; Te perfaqesoje shoqerine perpara bankave te nivelit te dyte dhe Bankes se Shqiperise si dhe te kryej cdo transaksion bankar ne emer te shoqerise; Te ndermarre cdo veprimtari tjetet, ose biznes, ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshem peradministrimin efikas te Shoqierise ne Shqiperi.

12.4 Mandati i administratorit do te jete i vlefshern per pese vjet me te drejte ripertitje ose deri ne castine revokimit te tij me vendim te Asamblese se Ortakeve.

12.5 Administratori i Shoqerise mund ti transferoje cdo personi apo grupi personash te gjitha apo nje pjese te kompetencave te tij sipas ketij Statuti dhe me kushtet qe ai konsideron si te arsyeshme dhene cdo kohe mund te anulloje kete transferim kompetencash.

NENI 13 - VITI FINANCIAR

13.1 Viti financiar i shoqerise perputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe perfundon me 31 Dhjetor te cdo viti.

13.2 Perjashtimisht, viti i pare financiar i shoqerisa do to filloje nga dita e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe perfundon me 31 Dhjetor të po atij viti.

NENI 14 - BILANCI. KONTABILITETI.

14.1 Bilancl vietor i shoqerise shqyrtohet nga Asambleja e Ortakeve dhe duhet te pergatitet per t'u paraqitur para organeve tatimore dhe Qendres Kombetare te Regjistrimit deri ne fund te muajit Mars to cdo viti pasardhes.

14.2 Kontabiliteti mbahet ne gjuhen dhe monedhen shqiptare si dhe sipas kerkesave te legjislacionit perkates. Per operatione te vecanta, shoqeria mund te beje veprime edhe me te vecanta nemonedhe te huaj, duke bere konvertimin brenda vitit.

14.3 Shoqeria mund te pranoje fonde nga institucionet financiare qe operojne ne Shqiperi ose jashte. Per kete qellim shoqeria mund te lere peng pjese te kapitalit si garanci ose mund te hipotekoje pasurite e saj te paluajtshme, vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve.

NENI 15 - TE ARDHURAT, DIVIDENDI

15.1 Shoceria mund te krijoje fonde rezerve per realizimin e qellimeve te aktivitetit te saj ne perputhje me kerkesat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

15.2 Fitimet qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo viti ushtrimor, pas pagimit te tatimeve, mund te ndahen nga Asambleja e Ortakeve.

15.3 Humbjet e shoqerise do te mbulohen deri ne kufirin e kapitalit themeltar dhe cdo ortak do te pergjigjet deri ne kufirin e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

pergjigjet den i ne kufirin e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

NENI 16 — LIKUIDIMI

16.1 Likuidimi e Shoqerise si dhe emerimi i likuidatorit(eve) behet ne perputhje me ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, dhe gdo ligj tjeter te zbatueshem.

NENI 17— MOSMARREVESHJET

17.1 Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis shoqerise dhe te treteve, ne rast se nuk zgjidhen me mirekuptim do ti nenshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

NENI 18 - KLAUZOLE MBYLLESE


16.1 Ky Statut hartohet ne 3 (tre) kopje.

ORTAKET

Z. Niko Gjani

Znj. Ermalinda Gjani

Date 05.11.2021

Niko Gjani 
Ermalinda Gjani 